

THIRRRJE PËR GRANTE

Sesion Informimi
11 Korrik 2025

**MËSO TË RIVLERËSOSH.
MOS SHPËRDORO!**

Advancing Gender-Responsive Circular
Economy Models



Implemented by:

PERMBAJTJA

- Paketa e Aplikimit
- Mbështetja financiare
- Përgjigjshmëria Gjimore në Ekonominë Qarkulluese
- Pyetje dhe Përgjigje



EU 4 CIRCULAR ECONOMY AND LIVABLE CITIES




Co-funded by the European Union



Implemented by




Rreth EU4CELC – Projekti I EU for Circular Economy and Livable Cities (EU4CELC) / BE-ja
Për Ekonominë Qarkulluese dhe qytete të jetueshme është një projekt cili bashkëfinancohet nga Bashkimi Europian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe zbatohet nga GIZ Albania në partneritet me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.





Objektivat e projektit tonë

- Krijimi i **bazave ligjore dhe financiare** për praktikat e ekonomisë qarkulluese
- **Forcimi i kapaciteteve** të institucioneve për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve dhe ujërave të ndotura në përputhje me direktivat e BE-së.
- Zhvillimi i **praktikave të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe me përgjegjshmëri gjinore.**
- Nxitja dhe mbështetja e sektorit privat për kalimin drejt një ekonomie qarkulluese



Sesion Informimi

11 Korrik 2025

**MËSO TË RIVLERËSOSH.
MOS SHPËRDORO!**

Advancing Gender-Responsive Circular
Economy Models



Implemented by:

PAKETA E APLIKIMIT


Qëllimi i përgjithshëm: të mbështesë nisma inovative që ndërthurin parimet e ekonomisë qarkulluese me përgjigjshmëri gjinore.

Objektivat specifike:

- Të mbështesë zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve të ekonomisë qarkulluese me përgjigjshmëri gjinore, të cilat promovojnë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve dhe reduktimin e mbetjeve, duke siguruar një pjesëmarrje të barabartë ekonomike.
- Të forcojë kapacitetet e komuniteteve, bizneseve dhe organizatave për të adoptuar, zbatuar dhe përshkallëzuar modele të ekonomisë qarkulluese me përgjigjshmëri gjinore, për qëndrueshmëri dhe ndikim afatgjatë.

PAKETA E APLIKIMIT

Shtrirja gjeografike: gjithë territori i Shqipërisë



KRITERET E APLIKIMIT

Kush mund të aplikojë?

1. Organizatat jo fitimprurëse (OJF) dhe “grassroots”
2. Universitetet dhe qendrat kërkimore
3. Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM)

Kush nuk mund të aplikojë?

1. Individët
2. partitë politike
3. organizatat ndërkombëtare dhe të huaja
4. institucionet qeveritare

KRITERET E APLIKIMIT

Kriteret për aplikantët

- Të jenë të regjistruar sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë
- Të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Shqipërisë
- Të jenë përgjegjës të drejtpërdrejtë për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit
- Të jenë regjistruar 2 vite përpara afatit të aplikimit në këtë thirrje
- Të kenë ekipe pune/staf të përbërë prej 3-25 anëtarë
- Të punojnë në fushat e veprimit të kësaj thirrje
- Në rastin e NVM-ve, nuk duhet të kenë përfituar nga skema grantesh/mbështetje nga donatorë në dy vitet e fundit

**Një aplikant mund të dorëzojë më shumë se një aplikim me kushtin që çdo aplikim i dorëzuar duhet të trajtojë një problematikë të veçantë.*

KRITERET E APLIKIMIT

Bashkë-aplikantët dhe partnerët e asociuar

- Partneriteti i një aplikanti me aplikantë të tjerë nuk është i detyrueshëm.
- **Nxitet**, në rast se aplikanti e konsideron vlerë të shtuar, partneriteti pa buxhet (asocimi) me institucionet e pushtetit vendor dhe njësitë e formës së partneritetit publik privat. Në këtë rast aplikanti duhet të sigurojë **një letër mbështetëse** që të përmbajë të dhënat, shprehjen e interesit dhe mbështetjen e partnerit të asociuar.

KRITERET PËR PROJEKT PROPOZIMET

Projektet të kontribuojnë drejtpërdrejtë në:

(I) ekonominë qarkulluese, **(II)** përfshirjen sociale dhe barazinë gjinore, dhe **(III)** fuqizimin e të rinjve dhe grupeve të marxhinalizuara.

Temat prioritare (Jo të kufizuara):

- Zgjidhje për zvogëlimin ose ripërdorimin e mbetjeve tekstile, ushqimore, plastike etj.;
- Modele biznesi që krijojnë vende pune të drejtpërdrejta për gra dhe të rinj;
- Inovacion digjital (aplikacione, platforma, analiza të dhënash) i cili lehtëson ekonominë qarkulluese;
- Nisma që përfshijnë komunitete rome/egjiptiane, persona me aftësi të kufizuara ose banorë të zonave rurale në zinxhirin e vlerave qarkulluese.
- Ngritje kapacitetesh me fokus pjesëmarrjen e barabartë të grave;

AKTIVITETET - Kategoritë

Thirrja mbështet tre kategori kryesore aktivitete (lista jo shteruese):

1. Zgjidhje praktike të ekonomisë qarkulluese (p.sh. riparim tekstilësh, kompostim, refill station etj.);
2. Fuqizim socio-ekonomik me fokus barazinë gjinore (trajnime, kooperativa, krijim vendesh pune për gra & të rinj etj.);
3. Inovacion dhe ndërgjegjësim (hackathon, platforma digjitale, fushata edukative, etj).

**Çdo projekt duhet të adresojë të paktën një kategori. Projektet që ndërthurin dy ose më shumë kategori marrin pikë shtesë.*

Sesion Informimi

11 Korrik 2025

**MËSO TË RIVLERËSOSH.
MOS SHPËRDORO!**

Advancing Gender-Responsive Circular
Economy Models



Implemented by:

MBESHTETJA FINANCIARE



MBESHTETJA FINANCIARE

- Shuma totale e alokuar për ndarjen e nëngranteve është 100,000 EUR
- Shuma maksimale e mbështetjes financiare për nëngrant është 20,000 EUR.
- Kohëzgjatja e projektit është 4 muaj të plotë, as më shumë dhe as më pak.
- Parashikimi i investimeve nuk është kriter detyrues dhe mos parashikimi i tyre nuk është kriter penalizues.
- Bashkëfinancimi nuk është kriter detyrues në këtë thirrje për aplikim.

KOSTOT E LEJUESHME

- **Kostot e pranueshme**

- Vetëm “Kostot e pranueshme” mbështeten financiarisht.
- Të bazohen në vlera reale dhe të shoqërohen nga dokumenta mbështetëse.
- Aplikantët e përzgjedhur do t’i nënshtrohen një procesi kontrolli buxhetor para nënshkrimit të kontratës, për të nxjerrë në pah probleme apo çështje që kërkojnë ndryshime në buxhet (gabime aritmetike, pasaktësi ose kosto jo reale, kosto të tjera të papranueshme).
- Të paraqitet një buxhet realist dhe me kosto efektive.

- **Kriteret për kostot e lejuara**

Të gjitha kostot e parashikuara në buxhetin e projektit duhet të përmbushin të gjitha kriteret e mëposhtme:

- Të jenë kryer gjatë periudhës së zbatimit të grantit;
- Të jenë në përputhje me kategoritë e linjave të buxhetit;
- Të jenë të nevojshme për zbatimin e projekt propozimit;
- Të jenë të identifikueshme, të verifikueshme dhe të dokumentuara;
- Të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të tatim taksave në Shqipëri;
- Të jenë të arsyeshme, efikase, të justifikuara dhe të jenë kryer në kuadër të menaxhimit të shëndoshë financiar;
- Të jenë në përputhje me legjislacionin kombëtar shqiptar në fuqi;

KOSTOT E LEJUESHME


- **Kosto të drejtpërdrejta të pranueshme**
- Kostot e stafit të caktuar për zbatimin e projektit (pagat bruto aktuale + sigurimet shoqërore & shëndetsore)
- Shpenzimet e udhëtimeve dhe dietave për stafin dhe personat e tjerë që marrin pjesë në projekt
- Kostot e blerjeve për pajisje (të reja ose të përdorura) dhe shërbime të posaçme për qëllimet e projektit;
- Kostot e shpenzimeve të qirasë së zyrave dhe furnizimeve me materiale të konsumueshme të dedikuara posaçërisht për qëllimet e projektit (vetëm për organizatat jo fitimprurëse);
- Kostot e drejtpërdrejta të zbatimit të aktiviteteve si shërbime, vizibilitet, aksione etj, për qëllimet e projektit;

KOSTOT E LEJUESHME

Kosto të papranueshme

- Detyrimet doganore;
- Borxhet dhe interesat e tyre; Kredia për palët e treta;
- Dispozitat për humbjet ose detyrimet e mundshme në të ardhmen;
- Kostot e deklaruar nga përfituesi dhe të financuara nga një projekt ose program tjetër;
- Blerja e tokës ose ndërtesave; Blerja e automjeteve dhe telefonave celularë;
- Humbjet nga këmbimi valutor;
- Kostot e garancisë bankare ose çdo garanci tjetër;
- Gjobat, penalitetet financiare dhe shpenzimet për mosmarrëveshjet ligjore;
- Kostot e qirasë së zyrave për njësitë që nuk janë organizata jo fitimprurëse; Tarifa e regjistrimit të biznesit;
- Kostot e pagave të personelit të administratës shtetërore, publike;
- Produktet ose shërbimet që i përkasin sektorëve specifikë që nuk janë të pranueshme në përputhje me praktikat e BE-së (si psh.prodhimi i alkoolit, duhani, lojërat e fatit, ushtria);

FORMATET E APLIKIMIT



Projekt propozimet duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe.

Forma e aplikimit (Aneksi I)

Forma e buxhetit (Aneksi II)

Matrica e Kuadrit Logjik (Aneksi III)

Dokumentat mbështetëse:

Në varësi të formës ligjore të regjistrimit të aplikantit

DOREZIMI I APLIKIMIT

Paketa e aplikimit së bashku me dokumentat shoqëruese do të dorëzohet online në platformën g-drive


<https://forms.gle/mi7vCkPuEu6hV9mu5>

Afati për dorëzimin e aplikimit është **27 Korrik 2025, ora 23:59.**

VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE

FAZA 1: Hapja dhe kontrolli administrativ i projekt propozimeve

FAZA 2: Vlerësimi i projekt propozimeve



Sesion Informimi

11 Korrik 2025

**MËSO TË RIVLERËSOSH.
MOS SHPËRDORO!**

Advancing Gender-Responsive Circular
Economy Models



Implemented by:

KOMPONENTI I PERGJIGJSHMERISE GJINORE NE EKONOMINE QARKULLUESE



PERKUFIZIM DHE ANALIZA GJINORE

Përgjigjshmëria gjinore nënkupton njohjen, trajtimin dhe adresimin aktiv të dallimeve gjinore në role, nevoja, mundësi dhe përvoja, me qëllim **promovimin e barazisë gjinore** në të gjitha fushat e politikave, programeve dhe praktikave institucionale apo shoqërore.

Projektet që do mbështeten nga kjo thirrje duhet të integrojnë parimet e ekonomisë qarkulluese me përgjigjshmërinë gjinore. Për këtë arsye, një kriter shumë i rëndësishëm i projekteve është që të tregojnë një lidhje të qartë midis zgjidhjeve të ekonomisë qarkulluese dhe përgjigjshmërisë gjinore.

Për të ndihmuar integrimin e komponentit të përgjigjshmërisë gjinore në projekt idetë tuaja dhe për të matur arritjet, ju vjen në ndihmë formati i analizës gjinore i cilë është pjesë e kornizës logjike të paketës së aplikimit.

(shpjegimi i formatit të analizës gjinore)

PERQASJA E PERGJIGJSHMERISE GJINORE NE EKONOMINE QARKULLUESE

Modele te ekonomise qarkulluese me pergjigjshmeri gjinore ne Shqiperi qe avancojne barazine gjinore

Ky projekt ka dy qëllime thelbësore: **zhvillimin e qëndrueshëm dhe barazinë gjinore**. Iniciativa mbështet projekte lokale në Shqipëri që integrojnë praktikën e ekonomisë qarkulluese me përgjigjshmerinë gjinore.

Ekonomia Qarkulluese me përgjigjshmeri gjinore është një qasje ndaj ekonomisë qarkulluese që integron në mënyrë aktive barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në të gjitha fazat e sistemeve ekonomike qarkulluese - projektimin, prodhimin, konsumin, ripërdorimin dhe riciklimin. Ajo pranon se gratë dhe burrat shpesh kanë role, nevoja, qasje në burime dhe ndikime të ndryshme brenda sistemeve ekonomike, dhe synon të sigurojë që politikën dhe praktikën e ekonomisë qarkulluese të mos përforcojnë pabarazitë gjinore, por përkundrazi të promovojnë rezultate gjithëpërfshirëse dhe të barabarta.

Qëllimi

Fuqizimi i grave, të rinjve dhe komuniteteve të marginalizuara, veçanërisht grave Rome, për të udhëhequr dhe përfituar nga zgjidhjet që reduktojnë mbetjet, promovojnë ripërdorimin dhe ndërtojnë një ekonomi të gjelbër dhe gjithëpërfshirëse.

Pse tani?

Shqipëria po bën përparime në fushën e qëndrueshmërisë, por ende ka boshllëqe të rëndësishme, si sisteme të dobëta menaxhimi të mbetjeve, politika që shpesh nuk përfshijnë dimensionin gjinor, mungesa financiare për grupet e nënpërfaqësuar.

PERQASJA E PERGJIGJSHME GJINORE NE EKONOMINE QARKULLUESE

Gratë dhe grupet e marxhinalizuara shpesh përjashtohen nga mundësitë në sektorin e gjelbër për shkak të mungesës së burimeve financiare, teknike, ose përfaqësimit.(termi “gender ëashing”- shplarja gjinore)

Iniciativat e ekonomisë qarkulluese nuk përfshijnë automatikisht barazinë, dhe mund të riprodhojnë pabarazitë ekzistuese nëse nuk ndërhyjmë qëllimisht.(gender ëashing)

PERQASJA E PERGJIGJSHMERISE GJINORE NE EKONOMINE QARKULLUESE

Fusha	Kontrolli për elementin e përgjigjshmërisë gjinore	Pse ndihmon
Analiza gjinore	Rolet dhe nevojat e grave përgjatë zinxhirit qarkullues ose në zgjidhjen e propozuar në koncept (dizajn → konsum → riparim → riciklim).	Siguron që projekti bazohet në evidenca reale dhe shmang “gender-washing”.
Objektiva SMART	Objektivat e projektit tuaj adresojnë në mënyrë Specifike, të Matshme, të Arritshme, të mbështetura në Rezultat, dhe brenda afatit Kohor çështjet e përgjigjshmërisë gjinore si: <i>punësimi i grave, rritja e kapaciteteve të grave, mbështetja e nismave të udhëhequra nga gratë etj.</i>	Lehtëson matjen e ndikimit brenda afatit 4-mujor.
Tregues gjinor	Tregues cilësor dhe sasior që tregojnë qartësisht zhvillimin e gruas. Psh: <i>% gra/vajza në pozicione vendimmarrëse; nr. i vendeve të punës së krijuara për gratë; kg mbetje të shmangura falë nismave/praktikave të drejtuara nga gra etj.</i>	Harmonizim me kriteret e vlerësimit që tashmë kërkojnë “ndikim” mbi grupet përfituese.
Struktura e ekipit	Ekipi i projektit të ketë balancë gjinore	Reflekton objektivat kryesore të thirrjes.

PERQASJA E PERGJIGJSHME GJINORE NE EKONOMINE QARKULLUESE

Këto janë **shembuj** real që kombinojnë barazinë gjinore me ekonominë qarkulluese:

Kooperativa riciklimi të drejtuar nga grate Ringjallja e praktikave tradicionale psh te Grave Rome të cilat drejtojnë biznese për riciklimin e tekstileve, duke krijuar të ardhura dhe duke reduktuar mbetjet.

Iniciativa kulturore dhe artistike Teatër, art publik apo dokumentarë që tregojnë rolin e grave dhe komuniteteve të marginalizuara në ruajtjen e burimeve dhe zakoneve lokale.

Turizëm i qëndrueshëm Projekte ku grate dhe të rinjtë krijojnë produkte artizanale nga materiale të riciklueshme për t'i shitur në tregun turistik.

Zhvillimi i **programeve të mentorimit dhe lidërshit për grate sipërmarrëse në sektorët e gjelbër dhe inovativ**, ose inkubatorë për biznese në fushat e produkteve të qëndrueshme, tekstileve të ricikluara apo paketimit të gjelbër;

Qendra komunitare për reduktim, riparim ripërdorim, riciklim, rigjenerim
Hapësira të drejtuar nga grate që promovojnë përdorim të përbashkët të mjeteve, rrobave dhe pajisjeve duke reduktuar konsumin dhe forcuar lidhjet sociale. Apo (biokarburantet)